



PISA

MANUAL ME MODELE TESTESH BAZUAR NË SIMULIMET E PLATFORMËS PHET INTERACTIVE SIMULATION

PHET™

FIZIKË



MATEMATIKË



KIMI



BIOLOGJI



Dhjetor 2024

www.ascap.edu.al

Punuan dhe koordinuan hartimin e manualit:



Dorina Rapti

Mirela Gurakuqi

Mimoza Milo

Elisabeta Paja

Copyright © ASCAP, 2024



Përmbajtja



I. Hyrje	04
1.1. Kujt i shërben manuali dhe rëndësia e tij	04
1.2. Rëndësia e vlerësimit të nxënësve përmes aktiviteteve në Platformën PhET Interactive Simulations	06
1.3. Struktura dhe llojet e pyetjeve në testet bazuar në platformën PhET Interactive Simulations	07
1.4. Logjistika për organizimin dhe zhvillimin e testeve bazuar në platformën PhET Interactive Simulations	09
1.5. Ngjashmëria e testeve në PISA me testet bazuar në platformën PhET Interactive Simulations	10
II. Modele testesh me platformën PhET Interactive Simulations	14
2.1. Modele testesh me platformën PhET Interactive Simulations në matematikë	14
2.2. Modele testesh me platformën PhET Interactive Simulations në fizikë	45
2.3. Modele testesh me platformën PhET Interactive Simulations në kimi	110
2.4. Modele testesh me platformën PhET Interactive Simulations në biologji	129
III. Bibliografia	155

I. HYRJE

Manuali për hartimin e testeve me simulime interaktive bazuar në platformën PhET Interactive Simulations është hartuar nga specialistët e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar si një material ndihmës për mësuesit e shkencave të natyrës dhe matematikës.

Në manual përshkruhet struktura e testeve, duke ofruar një informacion të plotë mbi formatin dhe tipologjinë e pyetjeve, që mund të përdoren për të vlerësuar aftësitë e nxënësve në këto fusha. Po ashtu, manuali trajton aspektet logjistike dhe praktike të implementimit të testeve në mjedisin shkollor, duke përfshirë procedurat për organizimin dhe administrimin e tyre në klasë. Një tjetër element i rëndësishëm i manualit është krahasimi i këtyre testeve me formatin e përdorur në vlerësimin ndërkombëtar të PISA, veçanërisht për lëndët e shkencave natyrore dhe matematikën, për të theksuar ngjashmërinë dhe përputhshmërinë e metodave të vlerësimit. Më tej, manuali ofron modele konkrete testesh për lëndët e matematikës, fizikës, kimit dhe biologjisë, duke përdorur PhET Interactive Simulations si një metodologji e re dhe inovatore në procesin e mësimdhënies dhe vlerësimit të njohurive shkencore përmes teknologjisë.

Ky manual i vjen në ndihmë mësuesve pas 2 udhëzuesve¹ për mësimin e kombinuar në lëndët e shkencave të natyrës dhe matematikës, publikuar nga ASCAP, nëntor 2023.

- ASCAP, 2023, Udhëzuesi i simulimeve për klasat VI -IX, AMU, qershor 2023
- ASCAP, 2023, Udhëzues me simulime për klasat X-XII, AML, shtator 2023

1.1. Kujt i shërben manuali dhe rëndësia e tij

Manuali për hartimin e testeve bazuar në platformën PhET Interactive Simulations shërben për të udhëzuar mësuesit si të hartojnë teste duke përdorur simulimet (applet-et) e platformës www.phet.colorado.edu.

Kjo metodologji inovative për hartimin e testeve, e mbështetur në përdorimin e simulimeve të platformës PhET Interactive Simulations ofron mundësi të rëndësishme për përgatitjen e nxënësve për testimin PISA, i cili që nga viti 2015² përmban simulime interaktive në vlerësimin e kompetencave shkencore. Kjo qasje është në përputhje me strukturën e re të këtij testimi ndërkombëtar, duke ndihmuar nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre për kryerjen e testeve në lëndën e shkencave të natyrës

¹ ASCAP, 2023, Udhëzuesi i simulimeve për klasat VI-IX, AMU, 19.09.2023, pdf_ASCAP, 2023, Udhëzues me simulime për klasat X-XII, AML, 15 shtator 2023, pdf

² OECD, PISA_2015_Science_Framework

dhe matematikës dhe për t'u përshtatur me formatin dhe kërkesat e reja të vlerësimit në shkolla. Testet e hartuara me simulimet e platformës PhET Interactive Simulations shërbejnë për një gamë të gjerë përdoruesish dhe grupe interesi, duke përfshirë mësuesit, nxënësit, drejtuesit e shkollave, specialistët e arsimit, drejtuesit e rrjeteve lëndore dhe koordinatorët e sigurimit të cilësisë në shkollat tona. Ato ofrojnë mundësinë e vlerësimit të njohurive dhe aftësive të nxënësve në shkenca dhe matematikë, duke përdorur simulime interaktive për të mbështetur mësimin dhe vlerësimin. Këto teste u shërbejnë:

- **Mësuesve** për të vlerësuar aftësitë e nxënësve mbi njohuritë shkencore dhe matematikore, si dhe për t'i përgatitur ata për provime dhe vlerësime të brendshme dhe të jashtme, kombëtare apo ndërkombëtare si: PISA dhe TIMSS-i. Gjithashtu u shërben mësuesve si një material burimor didaktik që demonstron sesi teknologjia mund të përdoret dhe përmirësohet në shkollë për qëllime të vlerësimit.
- **Nxënësve** për të përforcuar njohuritë e tyre, për t'u përgatitur për provime dhe për të zhvilluar aftësitë e tyre të zgjidhjes analitike të ushtrimeve dhe interpretimit të rezultateve, duke nxitur mendimin kritik dhe krijues. Gjithashtu testet u ofrojnë nxënësve mundësinë e mësimin të pavarur dhe perceptimin e qartë të koncepteve shkencore dhe matematikore. Gjithashtu i ndihmon ato të marrin feedback lidhur me performancën e tyre në shkencat e natyrës përmes përdorimit të teknologjisë dhe për të arritur një progres në rezultatet e tyre.
- **Drejtuesve të shkollave** për të monitoruar dhe vlerësuar progresin e nxënësve, për të përshtatur kurrikulat dhe për të përmirësuar metodologjinë mësimore, duke identifikuar nevojat për mbështetje shtesë.
- **Koordinatorëve të sigurimit të cilësisë** në shkolla për të zhvilluar profesionalisht mësuesit e shkencave të natyrës dhe matematikës me praktika të reja vlerësimi duke përdorur teknologjinë.
- **Specialistëve të kurrikulës** për të krijuar dhe përmirësuar materiale mësimore, që i përgjigjen nevojave të nxënësve, duke siguruar që aktivitetet edukative të jenë efektive dhe të përshtatura me kërkesat e mësimin të sotëm mbi bazat e një metodologjie që promovon përdorimin e platformave digjitale.
- **Pedagogëve** të institucioneve të arsimit të lartë që përgatisin mësues në lëndën e shkencave të natyrës dhe matematikës që ti përdorin si material burimor për të ndihmuar formimin fillestar të studentëve të tyre që do të jenë mësuesit e rinj në të ardhmen.
- **Prindërve** që të mbështesin fëmijët në mësimin jashtë shkollës dhe të ndjekin progresin e tyre përmes testeve, duke i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë konceptet shkencore dhe matematikore dhe të përgatiten për sfidat e ardhshme.

- **Studentëve dhe shkencëtarëve** për të analizuar dhe përforcuar kuptimin e teorive të avancuara dhe për të zhvilluar aftësitë e tyre kërkimore në fushat e shkencave natyrore dhe matematikës.

Përdorimi i testeve me simulime ofron mundësi për të përforcuar mësimin në një mënyrë praktike dhe interaktive, duke i ndihmuar të gjithë përdoruesit të zhvillojnë aftësi dhe njohuri të thella shkencore dhe matematikore.

1.2. Rëndësia e vlerësimit të nxënësve përmes aktiviteteve në Platformën PhET Interactive Simulations

Platforma PhET Interaktive Simulations ofron mundësi të larmishme për vlerësimin e nxënësve në lëndët: matematikë, fizikë, biologji dhe kimi. Këto aktivitete jo vetëm që e bëjnë mësimin më tërheqës, por gjithashtu ndihmojnë në vlerësimin e njohurive dhe aftësive të nxënësve në një mënyrë inovative, duke ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të tyre dhe duke i nxitur ata të mendojnë në mënyrë kritike e të zgjidhin probleme në mënyrë kreative.

Kjo platformë ofron mundësi për nxënësit të angazhohen aktivisht jo vetëm në procesin e mësimin, por edhe në simulime për vlerësimin e njohurive dhe aftësive të tyre. Nxënësit mund të punojnë në ritmin e tyre, duke lejuar një qasje më të personalizuar në vlerësim. Ata mund të eksperimentojnë me simulime të ndryshme dhe të shohin në kohë reale rezultatet e veprimeve të tyre. Gjithashtu platforma lejon krijimin e aktiviteteve të diferencuara që mund të përputhen me nivelet e ndryshme të nxënësve dhe stilet e të nxënësve. Ndërkohë edhe mësuesit mund të marrin informacione të menjëhershme mbi performancën e nxënësve dhe të identifikojnë pikat e forta dhe nevojat që kanë nxënësit për përmirësim.

Përdorimi i platformave PhET Interaktive Simulations në vlerësimin e nxënësve në lëndët shkencore është një qasje inovative që ofron përfitime të shumta. Ajo ndihmon në zhvillimin e një mësimi më të angazhuar dhe më efektiv, duke i mundësuar nxënësve të zhvillojnë aftësi të nevojshme për arritjet e tyre në procesin mësimor dhe formimin individual. Kjo platformë jo vetëm që lehtëson procesin e mësimdhënies, por gjithashtu ofron mundësi të reja për të monitoruar progresin e nxënësve në përdorimin e simulimeve për të vlerësuar aftësitë e nxënësve në zgjidhjen e problemeve matematikore, e simulimeve të eksperimenteve fizike, e simulimeve të proceseve biologjike, e manipulimeve të përbërësve kimikë, apo të observimeve të reagimeve në një mjedis virtual.

1.3. Struktura e testeve bazuar në platformën PhET Interactive Simulations

- ✓ Testet e ndërtuara duke u bazuar në platformën PhET Interactive Simulations kanë një strukturë të mirë përcaktuar, që synon të rritë efektivitetin e mësimit dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve. Këto teste janë të dizajnuara për të integruar simulimet interaktive në mënyrë që të ofrojnë një përvojë mësimore të thellë dhe gjithëpërfshirëse.
- ✓ Secili test fillon me një hyrje që shpjegon temën e mësimit, konceptet e së cilës do të vlerësohen përmes testimit. Kjo përfshin konceptet kryesore dhe rezultatet e të nxënësve, duke e bërë të qartë se çfarë do të mësojnë nxënësit dhe pse është e rëndësishme të zhvillohen testet me simulime (applete). Pas hyrjes, testi paraqet simulimin specifik që do të përdoret. Kjo është një pjesë thelbësore, pasi studenti duhet të ketë akses në simulim dhe të kuptojë se si të navigojë dhe të manipulojë variablet për të eksploruar konceptet në thellësi.

1.3.1. Llojet e pyetjeve që përdoren për hartimin e testeve me simulime interaktive

Një komponent kyç i testeve me simulime inetraktive janë pyetjet dhe veprimtaritë interaktive që inkurajojnë nxënësit të ndërveprojnë me simulimin. Këto pyetje³ klasifikohen si mëposhtë:

Pyetje me zgjedhje të shumëfishta: Pyetjet me zgjedhje të shumëfishta janë ndërtuar në formën e një pyetjeje ose pohimi, e ndjekur nga disa alternativa ku nxënësi duhet të zgjedhë si përgjigje alternativën e saktë. Kërkesa konjitive ndryshon në bazë të kompleksitetit të pyetjes dhe thellësisë së njohurive të nevojshme, që duhet të zotërojë nxënësi për t'iu t'ua përgjigjur.

Pyetje me fund të hapur: Pyetjet e hapura kërkojnë që nxënësit të gjenerojnë përgjigjet e tyre. Këto pyetje mund të përfshijnë përgjigje të shkurtra, shpjegime ose përshkrime. Kërkesa konjitive mund të variojë nga njohuritë bazë që zotëron nxënësi deri te aftësitë e të menduarit të nivelit më të lartë siç janë analiza dhe sinteza. Pyetje me fund të hapur janë pyetje, të cilat kërkojnë përgjigje të zgjeruara dhe të shpjegojnë një koncept, proces, ose dukuri shkencore apo matematikore.

Pyetje të mbyllura: Pyetje që ofrojnë disa opsione përgjigjeje dhe testojnë njohuritë e pjesëmarrësve në lidhje me konceptet shkencore apo matematikore. Përgjigjet mund të jenë me zgjedhje të shumëfishta, (V/G) ose POIJO.

³<https://www.ascap.edu/all/udhezuesi-per-pergatitjen-e-nxenesve-per-vleresimin-nderkombetar-pisa-matematikë/>
<https://www.ascap.edu/all/udhezuesi-per-pergatitjen-e-nxenesve-per-vleresimin-nderkombetar-pisa-fizikë/>
<https://www.ascap.edu/all/udhezuesi-per-pergatitjen-e-nxenesve-per-vleresimin-nderkombetar-pisa-biologji/>
<https://www.ascap.edu/all/udhezuesi-per-pergatitjen-e-nxenesve-per-vleresimin-nderkombetar-pisa-kimi/>

Pyetje me interpretim të dhënash: Në këto lloje pyetjesh nxënësve iu paraqiten një grup të dhënash, grafikë, diagrame ose tabela dhe u kërkohet të interpretojnë informacionin e paraqitur. Atyre mund t'u kërkohet të nxjerrin përfundime, të bëjnë parashikime ose të analizojnë prirjet. Këto lloj pyetjesh vlerësojnë aftësitë e nxënësve në analizën dhe interpretimin e të dhënave. Pyetje me interpretim të dhënash janë pyetje që kërkojnë një analizë të të dhënave, grafikëve, njehsimet shkencore apo matematikore dhe interpretimin e rezultateve.

Pyetje me interpretim grafikësh: Nxënësve mund t'u jepen diagrame, modele ose imazhe që lidhen me një koncept shkencor. Më pas atyre u kërkohet të analizojnë ose interpretojnë të dhënat nga grafiku. Kjo vlerëson aftësinë e tyre për të kuptuar informacionin vizual dhe për ta lidhur atë me njohuritë teorike.

Pyetje me situata nga jeta reale: Pyetjet me situata nga jeta reale u kërkojnë nxënësve të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për të zgjidhur probleme praktike. Kërkesat e ushtrimeve të tilla kërkojnë aftësi njohëse të lartë të njohurive, pasi nxënësit duhet të analizojnë situatën, të marrin vendime dhe të arsyetojnë zgjidhjet e tyre.

Pyetje me detyra eksperimentale përmes simulimeve interaktive: Pyetjet e shkencave të natyrës në testimin PISA, që nga viti 2015 janë ndërtuar në formën e eksperimenteve ose laboratorëve virtual me simulime interaktive. Atyre mund t'u kërkohet të parashikojnë rezultatet, të shpjegojnë fenomenet ose të nxjerrin përfundime bazuar në të dhënat eksperimentale, duke përdorur simulimin. Këto pyetje vlerësojnë të kuptuarit e nxënësve për parimet dhe metodën shkencore që përdorin. Simulimet dhe situatat e paraqitura në testimin PISA për shkencat e natyrës ofrojnë një mënyrë efektive për të vlerësuar se si nxënësit përdorin njohuritë e tyre për të zgjidhur probleme të ndryshme shkencore në mënyrë praktike. Këto simulime inkurajojnë nxënësit të zhvillojnë mendimin e tyre kritik, analitik, dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve në fushën e shkencave të natyrës në një mënyrë të përshtatshme. Përdorimi i teknologjisë informative dhe komunikuese nëpërmjet simulimeve në testimin PISA ndihmon në vlerësimin e aftësive digjitale dhe shkencore të nxënësve në nivel ndërkombëtar. Pyetje me detyra eksperimentale përmes simulimesh janë pyetje, të cilat kërkojnë zbatimin e koncepteve dhe dukurive shkencore apo matematikore në situata praktike gjatë eksperimenteve ose simulimeve interaktive.

Pyetje me përgjigje të zgjeruara: Këto pyetje kërkojnë që nxënësit të japin shpjegime ose argumentime të hollësishme në përgjigje të kërkesave. Atyre mund t'u kërkohet të vlerësojnë informacionin, të japin arsyetimin e duhur dhe të mbështesin mendimet e tyre me prova. Pyetje konceptuale me përgjigje të zgjeruara janë pyetje, të cilat testojnë kuptimin e pjesëmarrësve për

koncepte themelore fizike, pa kërkuar llogaritje të detajuara. Këto pyetje mund të kërkojnë përshkrime, identifikime, ose aplikime të koncepteve shkencore apo matematikore në situata të ndryshme.

Zgjidhja e problemeve në bashkëpunim: Në këtë grup pyetjesh ndeshemi me ushtrime të lidhura me përdorimin e koncepteve shkencore në situata reale, ku nxënësit duhet të argumentojnë zgjedhjet në bazë të njohurive të tyre shkencore. Këtu vlerësohet edhe aftësia e tyre për të bashkëpunuar, komunikuar dhe zgjidhur ushtrimet në çift ose në grup si pjesë e një ekipi.

Këto teste janë ndërtuar në ngjashmëri me testet në formën e njësive interaktive që përmban programi ndërkombëtar PISA për shkencat e natyrës dhe matematikës.

Një tipar i rëndësishëm i këtyre testeve është mundësia për të ofruar feedback të menjëhershëm. Për çdo pyetje ose veprimtari që kryejnë nxënësit, ato mund të marrin informacione mbi performancën e tyre, duke i ndihmuar të identifikojnë gabimet dhe të kuptojnë më mirë konceptet abstrakte.

Testet zakonisht mbyllen me një seksion reflektimi, ku nxënësit inkurajohen të mendojnë për atë që kanë mësuar. Kjo mund të përfshijë pyetje për të diskutuar mbi përvojën e tyre me simulimin dhe se si kjo ka ndikuar në kuptimin e qartë të temës. Në fund, shpesh ofrohen materiale shtesë dhe burime për të thelluar mësimin. Këto mund të përfshijnë lidhje me artikuj, video ose aktivitete të tjera që i ndihmojnë nxënësit të vazhdojnë eksplorimin e temës. Struktura e testeve të ndërtuara me PhET Interactive Simulations është një mjet i fuqishëm për të forcuar procesin mësimor. Kjo platformë siguron një qasje të integruar që inkurajon angazhimin aktiv, zhvillon aftësitë kritike dhe ndihmon në kuptimin e thellë të koncepteve shkencore dhe matematikore. Këto teste janë një shembull i shkëlqyer se si teknologjia mund të përdoret për të përmirësuar mësimin dhe për të krijuar një përvojë të pasur dhe të angazhuar për nxënësit.

1.4. Logjistika për organizimin dhe zhvillimin e testeve bazuar në platformën PhET Interactive Simulations

Testet e bazuara në platformën PhET Interactive Simulations ofrojnë një mundësi efektive dhe të thjeshtë për realizimin e testeve, duke shfrytëzuar burimet dhe teknologjinë e disponueshme në këtë platformë. Pas përgatitjes së testeve në përputhje me modelet e përshkruara në këtë manual, mësuesi mund t'ua shpërndajë ato nxënësve përmes email-it. Nxënësit, nga ana e tyre, mund të kryejnë testet duke përdorur pajisje elektronike si : laptop, tableta apo pajisje kompjuterike.

Një nga avantazhet kryesore të këtyre simulimeve është aftësia për t'u ekzekutuar lokalisht, pa pasur nevojë për lidhje të vazhdueshme me internetin. Nëse pajisjet nuk janë të lidhura me internetin, përdoruesit mund të shkarkojnë paraprakisht simulimet (applet-et), të cilat mund të ekzekutohen në kompjuter përmes programit JAVA⁴. Ky program mund të shkarkohet falas dhe mundëson realizimin e simulimeve pa kërkuar lidhjen me internetin.

Për të realizuar testet dhe simulimet, mësuesit dhe nxënësit duhet të shkarkojnë simulimet e nevojshme dhe t'i ruajnë ato në desktopin e kompjuterit të tyre. Kjo ofron mundësinë e ekzekutimit të simulimeve edhe në ambiente ku lidhja me internetin është e kufizuar ose e pamundur, duke siguruar një proces mësimor të pandërprerë dhe fleksibël. Përdorimi i kësaj platforme është një mundësi për të krijuar një mjedis mësimor të përshtatshëm, i cili mund të mbështesë mësimin dhe zhvillimin e aftësive të nxënësve në lëndët e shkencave natyrore dhe matematikës, si dhe të realizojë vlerësimin e nxënësve me testet bazuar në linqet e mëposhtme:

<http://phet.colorado.edu/simulation/science/>

<http://phet.colorado.edu/simulation/mathematics/>

1.5. Ngjashmëria e testeve në PISA me testet bazuar në platformën PhET Interactive Simulations

Testet e hartuara mbi bazën e platformës PhET Interactive Simulations kanë ngjashmëri të dukshme me testet e prezantuara në Kornizën PISA 2025⁵ për shkencat e natyrës. Kjo ngjashmëri mund të ilustruhet lehtësisht në njësinë interaktive "Efekti serë". Ky ushtrim është pjesë e Kornizës PISA 2025 për shkencat e natyrës dhe gjithashtu është i disponueshëm si aplikacion edhe në platformën PhET Interactive Simulations, e cila mundëson një mësim të bazuar në simulime interaktive. Përdorimi i këtij simulimi ofron mundësinë që nxënësit të eksplorojnë dhe të analizojnë efektet e ndryshimeve në atmosferë, si rritja e temperaturës globale për shkak të gazrave serë. Testet e hartuara përmes këtij simulimi janë një mjet efikas për të vlerësuar aftësitë e nxënësve në analizimin dhe interpretimin e dukurive shkencore, në përputhje me kërkesat e testimit PISA. Gjithashtu simulimi i "Efektit serë" i platformës PhET⁶ Interactive Simulations mundëson nxënësit të ndërmarrin eksperimente virtuale dhe të kuptojnë përmes eksperiencës se si variabilet e ndryshme ndikojnë në dukuritë shkencore.

⁴ IZHA, Shtator 2012, Mirela Gurakuqi, Bejo Duka, Guida praktike për lëndët Matematikë- Fizikë me CD, fq.3.

⁵ <http://pisa-framework.oecd.org/science-2025/>

⁶ www.phet.simulation.edu;

Simulimin “Efekti serë” e gjejmë në platformën PhET⁷ Interactive Simulations. Gjithashtu edhe në Kornizën PISA 2025 për shkencat e natyrës një nga njësitë interaktive të dhëna si shembuj është njësia interaktive “Efekti serë”. Simulimet në platformën PhET⁸ Interactive Simulations janë të ngjashme me simulimet e njësive interaktive të shkencave të natyrës nga viti 2015-2025. Duke punuar me platformën PhET⁹ Interactive Simulations nxënësit mund të përgatiten më mirë për testimin PISA, pasi duke përdorur lloje të ngjashme simulimesh dhe aplikacione interaktive. Kjo metodologji i ofron nxënësve mundësinë të përfitojnë nga një mësim i integruar dhe i thelluar, duke e bërë përgatitjen për PISA më të lehtë dhe më të efektshme.

1.5.1. Test me simulimin “Efekti serë” nga platforma PhET Interactive Simulations

Testi i mëposhtëm është hartuar përmes simulimit “Efekti serë” që përmban platforma PhET Interactive Simulations.

TEST NR. I

Tema: / Greenhouse Effect/Efekti Serë

Posted in PhET Interactive Simulations, Activity: Greenhouse Effect, by Author: Rachael Barret

Linku: https://phet.colorado.edu/sims/html/greenhouse-effect/latest/greenhouse-effect_all.html


Klasa: X-XII, AML

Pajisjet elektronike: Kompjuter, laptop, tabletë ose smartphone

Në platformën PhET Interactive Simulations klikoni linkun e mëposhtëm:

https://phet.colorado.edu/sims/html/greenhouse-effect/latest/greenhouse-effect_all.html që i përket temës “Efekti serë”.


Ky simulim¹⁰ shërben për të treguar marrëdhënien e rrezeve të dritës së diellit/UV me dritën infra të kuqe/IR. Para se të përdorni simulimin sigurohuni që termometri dhe reja të jenë aktivizuar. Klikoni kursorin "Start light". Përdorni kursorin e ndërrimit të "Përqendrimi i Gazrave Serë" për të zvogëluar dhe zmadhuar sasinë e CO₂.



¹⁰<https://phet.colorado.edu/en/for-teachers/browse-activities;>

1. Klikoni kursorin në figurën e mëposhtme për të ndryshuar vlerat e "Përqendrimit të gazrave Serrë" tek simulimi (applet-i) dhe plotësoni tabelën me vlerat e matura nga ekzekutimi i tij.

8 pikë




Të dhënat	Sasia e përqendruar e CO ₂	Temperatura e sipërfaqes
Epoka e Akullit		
Viti 1750		
Viti 1950		
Viti 2020		

a) Shpjegoni si ndryshon temperatura kur zvogëlohet sasia e CO₂-së në periudha të ndryshme?

3 pikë

b) Si ndryshon temperatura kur rritet sasia e CO₂-së në periudha të ndryshme?

3 pikë



2. Tani shkoni te modeli i shtresave për të parë efektin e shumë shtresave në atmosferë. Filloni simulimin me shtresën 0. Plotësoni tabelën e mëposhtme: **10 pikë**

Energy

Sunlight ●

Infrared ●

Sunlight

Solar Intensity

50% Our Sun 150% 200%

Surface Albedo

0 0.9

Infrared

0 Absorbing Layers

Infrared Absorbance

10% 100%

Shtresat absorbuese	Temperatura e sipërfaqes së tokës	Temperatura e shtresës 1	Temperatura e shtresës 2	Temperatura e shtresës 3
0				
1				
2				
3				

a) Si ndikon në temperaturën e sipërfaqes së Tokës rritja e numrit të shtresave absorbuese në atmosferë? **3 pikë**

3. Përshkruani efektet e gazeve serë nën ndikimin e dritës së diellit dhe rrezeve infra të kuqe.

4 pikë

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-11	12-15	16-20	21-25	26-28	29-30

II. MODELE TESTESH ME PLATFORMËN PHET INTERACTIVE SIMULATIONS

Platforma PhET Interactive Simulations ofron modele testesh interaktive për lëndët e matematikës, fizikës, kimisë dhe biologjisë, duke mundësuar që nxënësit të eksperimentojnë dhe të kuptojnë konceptet e ndryshme nëpërmjet simulimeve vizuale dhe veprimtarive praktike. Këto modele testesh që janë përgatitur mbi bazën e kësaj platforme janë të dizajnuara për të stimuluar mësimin aktiv dhe për të mundësuar nxënësit të provojnë dhe të analizojnë rezultate nga eksperimente të ndryshme. PhET gjithashtu ofron mundësi për krijimin e pyetjeve konceptuale dhe testeve, si dhe për të vlerësuar njohuritë e nxënësve pas çdo simulimi.

2.1. Modele testesh me platformën PhET Interactive Simulations në matematikë

TEST NR. I

Tema: Numrat e plotë

Linku: <https://phet.colorado.edu/en/simulations/number-line-integers>

Klasa: VI, AMU

Pajisjet elektronike: Kompjuter, laptop, tabletë ose smartphone

Në platformën PhET Interactive Simulations klikoni linkun e mëposhtëm:


<https://phet.colorado.edu/en/activities/7685>, që i përket temës “Numrat e plotë”.

Emër Mbiemër: _____

Le të bëjmë një zhytje në det...

I. Shikoni figurën dhe këtë informacion dhe plotësoni lidhur me pyetjet.

(4 pikë)




Kush është mbi det?
(Vendosni emërtimin)

Kush është brenda në
det? (Vendosni
emërtimin)

Në qoftëse do të duhet një shenjë, çfarë
shenje do të vendosni?

Pozitive: Negative:

Arsyetoni përgjigjen tuaj



Po në këtë rast
çfarë shenje do të
vendosni?

Pozitive:	Negative:
-----------	-----------

Arsyetonit përgjigjen tuaj

2. Cila është marrëdhënia ndërmjet detit dhe shenjave që zgjodhët për zogun dhe peshkun?


Argumentoni përgjigjen tuaj.

2 pikë

3. Tregoni me një shigjetë ku do ta vendosni shokun tonë (në PhET) sipas karakteristikave më poshtë:

Shënim. Figura është boshti numerik për nivelin e detit. (në, mbi, nën nivelin e detit)

5 pikë



Vajza PhET me parashutë



Vajza PhET zhytëse



Vajza PhET duke ecur



Arsyetonit përgjigjet tuaja

4. Renditni në mënyrë rritëse sipas pozicionit që i keni dhënë vajza PhET në kërkesën tre. (me parashutë/zhytëse/duke ecur)

4 pikë

Vajza PhET:

Vajza PhET:

Vajza PhET:

\leq

\leq

Lartësia më e vogël

Lartësia më e madhe

Arsyetoni përgjigjen tuaj

5. Çfarë përdorimesh të tjera mund të kenë numrat e plotë në jetën tuaj të përditshme? (paraqisni një shembull)

5 pikë

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	<5	5-7	8-10	11-13	14-16	17-18	19-20

TEST NR. 2

Tema: Numrat e plotë

Linku: <https://phet.colorado.edu/en/simulations/number-line-integers>

Klasa: VI-VII, AMU

Pajisjet elektronike: Kompjuter, laptop, tabletë ose smartphone

Në platformën PhET Interactive Simulations klikoni linkun e mëposhtëm:

<https://phet.colorado.edu/en/activities/7685>, që i përket temës “Numrat e plotë”.


Emri Mbiemri:



Mos harroni... verifikoni përgjigjet tuaja me simulimet.

1. Ngjyrosni termometrin sipas temperaturës së treguar në gradë Celsius

6 pikë




Cila është marrëdhënia ndërmjet numrave pozitiv, negativ, zero me temperaturat e ftohta dhe të ngrohta?

Arsyetoni përgjigjen tuaj

2. Shikoni shembullin: një temperaturë është vendosur në boshtin numerik. Në simulim tregoni temperatura të tjera me shenja të ndryshme.

3 pikë



Sipas simulimit në pikën 2, përgjigjuni kërkesave 3 dhe 4.

3. Cila është temperatura më e ulët?

2 pikë

Arsyetoni përgjigjen tuaj


4. Cila është temperatura më e lartë?

2 pikë

Arsyetoni përgjigjen tuaj

5. Zgjidhni sipas karakteristikave të kursimeve tuaja

6 pikë



- Nuk kam arritur të kursej
- Kam bërë shumë shpenzime, pa kursime
- Kam bërë shumë kursime, pa shpenzime

Argumentoni përgjigjen tuaj



- Nuk kam arritur të kursej
- Kam bërë shumë shpenzime, pa kursime
- Kam bërë shumë kursime, pa shpenzim

Argumentoni përgjigjen tuaj



- Nuk kam arritur të kursej
- Kam bërë shumë shpenzime, pa kursime
- Kam bërë shumë kursime, pa shpenzime

Argumentoni përgjigjen tuaj

6. Plotësoni fjalinë me fjalët: "kursim" dhe "shpenzim" në vendet bosh më poshtë: **2 pikë**

_____ shprehet me shenjë negative përpara sasisë (numrit), ndërsa _____ shprehet me shenjë pozitive.

7. Plotësoni tabelën më poshtë (kontrolloni me simulimin) **6 pikë**

Krahasoni numrat.

Paraqitini në boshtin numerik

Arsyetoni përgjigjen



Arsyetoni përgjigjen




Arsyetoni përgjigjen



Mos harroni... verifikoni përgjigjet tuaja me simulimet.

A e dini se ndryshimet klimatike po ndikojnë në temperaturat e planetit tonë?

Argumentoni përgjigjen tuaj.



8. Në cilët muaj të vitit janë regjistruar temperaturat më të ulëta?

4 pikë

Muaji	Vendndodhja në hartë	Temperaturat e matura	Përshkruani si ju duken këto të dhëna

9. Në cilët muaj të vitit janë regjistruar temperaturat më të larta?

4 pikë

Muaji	Vendndodhja në hartë	Temperaturat e matura	Përshkruani si ju duken këto të dhëna

10. Cili pol është më i ftohtë?

2 pikë

Poli i veriut

Poli i jugut

Nuk ka ndryshime

Gjykoni: Si arritët në këtë përgjigje?

11. Shkruani reflektimet tuaja nëse jeta e përditshme do të ishte e mundur pa përdorur numrat pozitiv, numrat negativ apo numrin zero.

3 pikë

Reflektimet:

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	<11	11-15	16-20	21-25	26-30	31-35	36-40

TEST NR. 3

Tema: Funksionet e fuqisë së dytë

Linku: <https://phet.colorado.edu/en/simulations/graphing-quadratics>


Klasa: X-XII, AML

Pajisjet elektronike: Kompjuter, laptop, tabletë ose
smartphon

Në platformën PhET Interactive Simulations klikoni linkun e mëposhtëm:

<https://phet.colorado.edu/en/simulations/graphing-quadratics> që i përket temës “Funksionet e fuqisë së dytë”.

Pasi të klikoni simulimin (applet-in) shfaqet në ekran figura e mëposhtme:



Klikoni ”download” në appletin e mësipërm do të shfaqet figura e mëposhtme:

Paraqitja grafike e funksioneve katrore



Eksploro



Forma standarde




Forma kanonike



Fokusi & Direktrisa

Klikoni butonin "Exploro" dhe në ekranin ku shfaqet "Paraqitja grafike e funksioneve katrore", menjëherë do të shfaqet figura e mëposhtme:



- I. Duke përdorur simulimin (applet-in) ndërtoni grafikun e funksionit $y = ax^2$, kur $a=0.53$, $b=0$ dhe $c=0$ dhe pasi ta ndërtoni përmes simulimit bëjini një screenshot grafikut të ndërtuar dhe vendoseni në fletën e testit, si dhe përcaktoni koordinatat e pikave ku grafiku pret boshtet koordinative.

6 pikë

2. Duke përdorur simulimin (applet-in) ndërtoni grafikun e funksionit linear kur $a=0$, $b= 2.1$ dhe $c=0$, dhe pasi ta ndërtoni përmes simulimit bëjini një screenshot grafikut të ndërtuar dhe vendoseni në fletën e testit, si dhe përcaktoni koordinatat e pikave ku grafiku pret boshtet koordinative:

6 pikë

3. Pasi të zgjidhni $c = 2.6$, ku grafiku është i formës $y= c$ -të, pra $a=0$ dhe $b=0$ dhe pasi ta ndërtoni përmes simulimit bëjini një screenshot grafikut të ndërtuar dhe vendoseni në fletën e testit, si dhe tregoni ku e pret boshtin e ordnatave ky grafik:

6 pikë

4. Ndërtoni grafikun e funksionit $y = ax^2 + bx + c$, kur vlerat e koeficienteve janë $a=2$, $b=3$ dhe $c = 1$, dhe pasi ta ndërtoni përmes simulimit bëjini një screenshot grafikut të ndërtuar dhe vendoseni në fletën e testit, si dhe përcaktoni vlerat e koordinatave të pikave ku grafiku pret boshtet koordinative.

6 pikë

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-6	7-9	10-12	13-16	17-20	20-22	23-24

TEST NR. 4

Tema: Funksonet e fuqisë së dytë (Graphing quadratics)

Linku: <https://phet.colorado.edu/en/simulations/graphing-quadratics>


Klasa: X-XII, AML

Pajisjet elektronike: Kompjuter, laptop, tabletë ose smartphone

Në platformën PhET Interactive Simulations klikoni linkun e mëposhtëm:

<https://phet.colorado.edu/en/simulations/graphing-quadratics> që i përket temës “Funksonet kuadratike”.

Pasi të klikoni simulimin (applet-in) shfaqet në ekran figura e mëposhtme:



Klikoni “download” në appletin e mësipërm do të shfaqet figura e mëposhtme:

Paraqitja grafike e funksioneve katrore



Eksploro



Forma standarde




Forma kanonike



Fokusi & Direktrisa

Klikoni butonin "Exploro" dhe në ekranin ku shfaqet "Paraqitja grafike e funksioneve katrore", menjëherë do të shfaqet figura e mëposhtme:



1. Ndërtoni grafikun e funksionit $y = x^2$, kur $a = 1$, dhe pasi ta ndërtoni përmes simulimit bëjini një screenshot grafikut të ndërtuar dhe vendoseni në fletën e testit, si dhe përcaktoni koordinatat e pikave ku grafiku pret boshtet koordinative: **6 pikë**

2. Ndërtoni grafikun e funksionit $y = ax^2 + bx + c$, ku $a = 3.06$, $b = 2.1$ dhe $c = 0$, dhe pasi ta ndërtoni përmes simulimit bëjini një screenshot grafikut të ndërtuar dhe vendoseni në fletën e testit, si dhe përcaktoni koordinatat e pikave ku grafiku pret boshtet koordinative: **6 pikë**

3. Ndërtoni grafikun e funksionit $y = ax^2 + bx + c$, ku $a = 3.06$, $b = 2.1$ dhe $c = 5.2$, dhe pasi ta ndërtoni përmes simulimit bëjini një screenshot grafikut të ndërtuar dhe vendoseni në fletën e testit, si dhe përcaktoni koordinatat e pikave ku grafiku pret boshtet koordinative:

6 pikë

4. Argumentoni matematikisht dhe krahasoni grafikët e funksioneve $y = 3.06x^2 + 2.1x$ me $y = 3.06x^2 + 2.1x + 5.2$.

2 pikë

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-5	6-7	8-10	11-13	14-16	17-18	19-20

TEST NR. 5

Tema: Funksionet e fuqisë së dytë (Graphing quadratics)

Linku: <https://phet.colorado.edu/en/simulations/graphing-quadratics>


Klasa: X-XII, AML

Pajisjet elektronike: Kompjuter, laptop, tabletë os smartphone

Në platformën PhET Interactive Simulations klikoni linkun e mëposhtëm:

<https://phet.colorado.edu/en/simulations/graphing-quadratics> që i përket temës “Funksionet kuadratike”.

Pasi të klikoni simulimin (applet-in) shfaqet në ekran figura e mëposhtme:



Klikoni ”download” në appletin e mësipërm do të shfaqet figura e mëposhtme:

Paraqitja grafike e funksioneve katrore




Eksploro



Forma standarde




Forma kanonike



Fokusi & Direktrisa

Klikoni butonin "Exploro" dhe në ekranin ku shfaqet "Paraqitja grafike e funksioneve katrore", menjëherë do të shfaqet figura e mëposhtme:



- I. Ndërtoni grafikun e funksionit $y = x^2$, kur $a = 1$, dhe pasi ta ndërtoni përmes simulimit bëjini një screenshot grafikut të ndërtuar dhe vendoseni në fletën e testit, si dhe përcaktoni koordinatat e pikave ku grafiku pret boshtet koordinative:

6 pikë

2. Ndërtoni grafikun e funksionit $y = ax^2 + bx + c$, ku $a = 1$, $b = -3$ dhe $c = 0$, dhe pasi ta ndërtoni përmes simulimit bëjini një screenshot grafikut të ndërtuar dhe vendoseni në fletën e testit, si dhe përcaktoni koordinatat e pikave ku grafiku pret boshtet koordinative:

6 pikë

3. Ndërtoni grafikun e funksionit $y = ax^2 + bx + c$, ku $a = 1$, $b = -3$ dhe $c = -4$, dhe pasi ta ndërtoni përmes simulimit bëjini një screenshot grafikut të ndërtuar dhe vendoseni në fletën e testit, si dhe përcaktoni koordinatat e pikave ku grafiku pret boshtet koordinative:

6 pikë

4. *Analizoni duke argumentuar matematikisht ndryshimet ndërmjet tre grafikëve të mësipërm që keni ndërtuar.*

3 pikë

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-5	6-8	8-10	10-12	14-16	17-19	19-21

TEST NR. 6

Tema: Mbledhja e vektorëve (Vector addition)

Linku: https://phet.colorado.edu/sims/html/vector-addition/latest/vector-addition_en.html


Klasa: X, AML

Pajisjet elektronike: Kompjuter, laptop, tabletë ose smartphone


Në platformën PhET Interactive Simulations klikoni linkun e mëposhtëm:

https://phet.colorado.edu/sims/html/vector-addition/latest/vector-addition_en.html që i përket temës “Mbledhja e vektorëve”.

Pasi të klikoni simulimin (applet-in) shfaqet në ekran figura e mëposhtme:



Klikojmë për të hapur aplikacionin dhe në ekran na shfaqet figura:



1. Duke ekzekutuar simulimin (applet-in) njehsoni shumën e dy vektorëve a dhe b , bëjeni me screenshot figurën dhe vendoseni në fletën e testit. Pastaj plotësoni tabelën referuar figurës që keni ndërtuar, duke përdorur simulimin (applet-in). ($31^{\circ} < \alpha < 90^{\circ}$)

10 pikë

Vektorët	Vlera numerike	Këndi i vektorit me boshtin ox	Projeksioni i vektorit sipas boshtit ox	Projeksioni i vektorit sipas boshtit oy
\vec{a}	11.3	31°		
\vec{b}	8	90°		
\vec{c}				

2. Duke ekzekutuar simulimin (applet-in) njehsoni shumën e dy vektorëve \vec{a} dhe \vec{b} , bëjeni me screenshot figurën dhe vendoseni në fletën e testit. Pastaj plotësoni tabelën referuar figurës që keni ndërtuar, duke përdorur simulimin (applet-in). ($20,6^{\circ} < \alpha < 90^{\circ}$)

10 pikë

Vektorët	Vlera numerike	Këndi i vektorit me boshtin ox	Projeksioni i vektorit sipas boshtit ox	Projeksioni i vektorit sipas boshtit oy
\vec{a}	17.1	20.6°		
\vec{b}	10.0	90°		
\vec{c}				

3. Duke ekzekutuar simulimin (applet-in) njehsoni shumën e tre vektorëve \vec{a} , \vec{b} dhe \vec{c} bëjeni me screenshot figurën dhe vendoseni në fletën e testit. Pastaj plotësoni tabelën referuar figurës që keni ndërtuar, duke përdorur simulimin (applet-in). ($-90^\circ < \alpha < 159^\circ$)

10 pikë

Vektorët	Vlera numerike	Këndi i vektorit me boshtin ox	Projeksioni i vektorit sipas boshtit ox	Projeksioni i vektorit sipas boshtit oy
\vec{a}	10.2	45°		
\vec{b}	13.9	159°		
\vec{c}	12.0	-90°		
\vec{d}				

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-10	11-14	15-19	20-24	25-27	28-30

TEST NR. 7

Tema: Krahasimi i thyesave (Fraction-matcher)

Linku: <https://phet.colorado.edu/en/simulation/fraction-matcher>


Klasa: VI-IX , AMU

Pajisjet elektronike: Kompjuter, laptop, tabletë os smartphone


Në platformën PhET Interactive Simulations klikoni linkun e mëposhtëm:

<https://phet.colorado.edu/en/simulation/fraction-matcher> që i përket temës “Krahasimi i thyesave (Fraction-matcher)”

Pasi të klikoni simulimin (applet-in) shfaqet në ekran figura e mëposhtme:




Pasi të klikoni simulimin (applet-in) “Krahasimi i thyesave (Fraction Matcher)” na shfaqet figura e mëposhtme:



Pasi klikojmë në faqen e mësipërme na shfaqen 8 nivelet e “Zgjidh nivelin” dhe duke përzgjedhur nga niveli i parë deri tek i teti ekzekutoni simulimin (applet-in) dhe plotësoni tabelën e mëposhtme:

Thyesat: Zgjidh nivelin!



1. Pasi të përzgjidhni nivelin 1 ekzekutoni simulimin (applet-in), duke i bashkangjitur thyesave figurën korresponduese. Me pas bëjini screenshot ekranit të plotësuar dhe vendoseni atë në fletën e testit.

3 pikë

2. Pasi të përzgjidhni nivelin 2 ekzekutoni simulimin (applet-in), duke i bashkangjitur thyesave figurën korresponduese. Me pas bëjini screenshot ekranit të plotësuar dhe vendoseni atë në fletën e testit.

3 pikë

3. Pasi të përzgjidhni nivelin 3 ekzekutoni simulimin (applet-in), duke i bashkangjitur thyesave figurën korresponduese. Më pas bëjini screenshot ekranit të plotësuar dhe vendoseni atë në fletën e testit.

3 pikë

4. Pasi të përzgjidhni nivelin 4 ekzekutoni simulimin (applet-in), duke i bashkangjitur thyesave figurën korresponduese. Me pas bëjini screenshot ekranit të plotësuar dhe vendoseni atë në fletën e testit.

3 pikë

5. Pasi të përzgjidhni nivelin 5 ekzekutoni simulimin (applet-in), duke i bashkangjitur thyesave figurën korresponduese. Më pas bëjini screenshot ekranit të plotësuar dhe vendoseni atë në fletën e testit.

3 pikë

6. Pasi të përzgjidhni nivelin 6 ekzekutoni simulimin (applet-in), duke i bashkangjitur thyesave figurën korresponduese. Më pas bëjini screenshot ekranit të plotësuar dhe vendoseni atë në fletën e testit.

3 pikë

7. Pasi të përzgjidhni nivelin 7 ekzekutoni simulimin (applet-in), duke i bashkangjitur thyesave figurën korresponduese. Më pas bëjini screenshot ekranit të plotësuar dhe vendoseni atë në fletën e testit. **3 pikë**

8. Pasi të përzgjidhni nivelin 8 ekzekutoni simulimin (applet-in), duke i bashkangjitur thyesave figurën korresponduese. Me pas bëjini screenshot ekranit të plotësuar dhe vendoseni atë në fletën e testit. **3 pikë**

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-10	11-14	15-19	20-24	25-27	28-30

TEST NR. 9

Tema: Funksonet e fuqisë së dytë (Graphing quadratics)

Linku: <https://phet.colorado.edu/en/simulations/graphing-quadratics>


Klasa: X-XII, AML

Pajisjet elektronike: Kompjuter, laptop, tabletë ose smartphone

Në platformën PhET Interactive Simulations klikoni linkun e mëposhtëm:

<https://phet.colorado.edu/en/simulations/graphing-quadratics> që i përket temës “Funksonet e fuqisë së dytë”.

Pasi të klikoni simulimin (applet-in) shfaqet në ekran figura e mëposhtme:



Klikoni ”download” në appletin e mësipërm do të shfaqet figura e mëposhtme:

Paraqitja grafike e funksioneve katrore



Eksploro



Forma standarde




Forma kanonike



Fokusi & Direktrisa

Klikoni butonin "Exploro" dhe në ekranin ku shfaqet "Paraqitja grafike e funksioneve katrore", menjëherë do të shfaqet figura e mëposhtme:



1. Ndërtoni grafikun e funksionit $y = ax^2 + bx + c$, kur $a = 3$, $b = 2$ dhe $c = 1$ dhe pasi ta ndërtoni përmes simulimit bëjini një screenshot grafikut të ndërtuar dhe vendoseni në fletën e testit.

4 pikë

2. Përcaktoni koordinatat e pikave ku grafiku pret boshtin e abshisave

2 pikë

3. Përcaktoni koordinatat e pikave ku grafiku pret boshtin e ordinatave.

2 pikë

4. Përcaktoni koordinatat e kulmit të parabolës.

2 pikë

5. Përcaktoni koordinatat e kulmit të parabolës.

2 pikë

6. Duke u bazuar në grafikun e ndërtuar shpjegoni si janë të orientuar krahët e parabolës lart apo poshtë.

2 pikë

7. Si ndryshon grafiku kur ndryshojmë vlerën e konstantes a në dy rastet (rritet dhe zvogëlohet)?

2 pikë

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-4	5-6	7-8	9-10	11-12	13-14	15-16

TEST 10

Tema: Elemente të trigonometrisë "Trig Tour"

Linku: <https://phet.colorado.edu/en/simulations/trig-tour>


Klasa: XII, AML

Pajisjet elektronike: Kompjuter, laptop, tabletë ose smartphone


Në platformën PhET Interactive Simulations klikoni linkun e mëposhtëm:

<https://phet.colorado.edu/en/simulations/trig-tour>, që i përket temës "Elemente të trigonometrisë".

Klikoni cursorin 'Intro' për të filluar ekzekutimin e simulimit (applet-it).



Pasi klikojmë simulimin (applet-in) në ekran na shfaqet figura e mëposhtme dhe fillojmë të ekzekutojmë simulimin.



I. Rrethoni alternativat e sakta duke përdorur simulimin.

1. Si ndryshon vlera e sinusit të një këndi kur këndi rritet nga 0° në 90° ?

1 pikë

- A) Vlera e sinusit rritet nga 0 në 1
- B) Vlera e sinusit zvogëlohet nga 1 në 0
- C) Vlera e sinusit mbetet konstant
- D) Vlera e sinusit zvogëlohet dhe pastaj rritet

2. Cili kënd ka të njëjtën vlerë për sinuset dhe kosinuset?

1 pikë

- A) 0°
- B) 45°
- C) 60°
- D) 90°

3. Cili prej funksioneve trigonometrike ka gjithmonë vlerë negative për këndet në kuadrantin e III?

1 pikë

- A) sin
- B) cos
- C) tg
- D) ctg

II. Përdorni simulimin për të përfunduar fjalitë më poshtë.

1. Kur këndi është _____, sinusi është 1 dhe kosinusi është 0.

1 pikë

2. Kur përdorni tangentin, vlera rritet pa kufi në këndin _____.

1 pikë

3. Në kuadrantin e katërt, kosinusi është gjithmonë _____.

1 pikë.

4. Një trekëndësh kënddrejtë përmban një kënd me vlerë 90° , ndërsa këndi tjetër është _____.

1 pikë

III. Zgjidhni problemet duke përdorur simulimin “Elementet e trigonometrisë” - “Trig Tour”.

1. Përdorni simulimin për të gjetur sa është sinusi dhe kosinusi i këndit 30° . Shkruani përgjigjen tuaj.

$$\sin(30^\circ) = \underline{\hspace{2cm}}$$

1 pikë

$$\cos(30^\circ) = \underline{\hspace{2cm}}$$

1 pikë

2. Eksploroni këndin prej 75° duke ekzekutuar simulimin “Trig Tour” dhe përcaktoni vlerën e $\text{tg}(75^\circ) = \underline{\hspace{2cm}}$.

1 pikë

3. Duke zbatuar simulimin “Trig Tour”, shpjegoni si mund të përdorni funksionet trigonometrike për të matur një largësi që është e paarritshme fizikisht?

2 pikë

4. Shpjegoni si ndryshojnë vlerat e sinusit dhe kosinusit në varësi të ndryshimit të këndit kur rrotullohem nga kuadrati i parë në të katërtin.

4 pikë

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-4	5-6	7-8	9-10	11-12	13-14	15-16

2.2. Modele testesh me platformën PhET Interactive Simulations në fizikë

TEST NR. I

Tema: Density/ Dendësia e trupave¹¹


Linku: <https://phet.colorado.edu/sims/html/density/latest/densityen.html>

Klasa: IX, AMU

Pajisjet elektronike: Kompjuter, laptop, tabletë ose smartphone.

Në platformën PhET Interactive Simulations klikoni linkun e mëposhtëm:

<https://phet.colorado.edu/sims/html/density/latest/densityen.html>, që i përket temës “Dendësia dhe notimi i trupave”.



Pasi të hapet aplikacioni i simulimit ju mund të përzgjidhni kuba me ngjyra të ndryshme, por me masa të njëjta dhe pastaj zhyteni ato në enën me ujë. Pastaj nxirrini dhe futini një nga një dhe përmes njehsimeve të thjeshta matni vëllimin e tyre. Madhësitë pasi ti lexoni direkt nga aplikacioni vendosini në tabelë dhe me këto të dhëna matni dendësinë e trupave. Pasi të plotësoni tabelën me vlerat që ju keni përzgjedhur në aplikacion ose të matura nga eksperimenti tregoni nëse kubat notojnë/pluskojnë apo zhyten.

¹¹ ASCAP, 2023, Mirela Gurakuqi, Udhëzues për zhvillimin e lëndës së fizikës në Arsimin e Mesëm të Lartë (Material ndihmës për mësuesit) (simulimet interaktive trajtohen si metodologji interaktive dhe shembull ore mësimore).

1. Plotësoni tabelën e mëposhtme:

16 pikë

Trupi/kubat	masa(kg)	vëllimi(L)	dendësia(kg/L)	Noton/zhyten
Blu				
Verdhë				
Jeshil				
Kuq				

Shënim $d_{ujit} = 1000\text{kg/m}^3 = 1000\text{g/L} = 1\text{kg/dm}^3 = 1\text{kg/L} = 1\text{g/mL}$

2. Argumentoni përgjigjen tuaj për secilin kub:

4 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____
- d) _____

3. Përzgjidhni dy kuba me vëllime të njëjtë, por me masa të ndryshme.

